

Të dashur kolegë,

Të dashur miq,

Hulumtimi i Komisionit Evropian është shqetësues për ndryshimet klimatike dhe ndikimin e tyre në Evropë, sipas të cilit, më të prekurit, me kushte ekstreme të motit dhe rritje të temperaturave prej 3 deri në 7 gradë, do të jenë vendet e rajonit të Evropës Juglindore, rajon ky që mbulon vendet tona.

Sa afër jemi me momentin kur mund të bëhemi “refugjatë klimatikë”?

Një nga gjërat e pakta që nuk mund të blejnë me para është koha. Por kjo është arsyeja pse paratë “blenë” motin dhe teksa paguajmë të gjithë është ndryshimi i klimës.

U prenë miliona pemë për dokumentet mbi të cilat ishin shkruar dhe nënshkruar shumë deklarata, plane, aksione shpëtimi të Shtëpisë sonë të vetme. Në të kundërtën, kompanitë globale të ndotjes kanë shpenzuar miliona për propagandën se ndryshimi i klimës është një proces normal ciklik në natyrë. Fatkeqësisht, ndërgjegjja nuk ka të njëjtën adresë si fitimi. Dhe për të qenë i sigurtë, në luftën për epërsi ekonomike, politikanët, drejtpërdrejt apo tërthorazi, pothuajse janë bërë “bashkëpunëtorë në krim”.

Ne, si përfaqësues të disa prej departamenteve më humane në qeveritë tona, kemi për detyrë të ngremë vazhdimisht alarmin për pasojat shkatërruese të ndryshimeve klimatike. Si Ministre e Kulturës, dëshiroj të theksoj se në mes të pandemisë globale të KOVID-19, Qeveria ime ka trefishuar buxhetin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe ka hapur një linjë të re buxhetore për ndërhyrje urgjente të trashëgimisë kulturore të rrezikuara. Dhe tani, kur të gjithë ne riformësojmë buxhetet, të detyruara nga arsye të njohura dhe të ardhme të panjohura, ne mbetemi të përkushtuar ndaj mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të vetëdijshëm për vlerën e saj të paçmuar qytetëruese. Me të njëjtin ndërgjegjësim se ndryshimi i klimës kërcënon identitetin tonë duke cenuar trashëgiminë kulturore, ne punojmë për të stabilizuar dhe ruajtur ndërtesat dhe vendet historike që, sipas vlerësimit të autoriteteve botërore, janë të ekspozuara drejtpërdrejt ndaj ekstremeve të ndryshimeve klimatike.

Duke e njohur rëndësinë e bashkëpunimit rajonal, me këtë rast dëshiroj të veçoj bashkëpunimin me Qendrën Evropiane për Trashëgiminë Bizantine dhe Post-Bizantine në Selanik, Greqi, me të cilën realizojmë bashkëpunim profesional, shkencor dhe arsimor në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, konkretisht kishën e shekullit të 12-të në Kurbinovë, të cilën e vendosëm në listën tentative të UNESCO-s. Me Republikën e Shqipërisë ne ndajmë mbrojtjen e Rajonit të Ohrit, i cili është regjistruar në listën e UNESCO-s si një trashëgimi natyrore dhe kulturore botërore me vlera të jashtëzakonshme. Fatkeqësisht, në këtë rajon fshihet jo vetëm rreziku i ndryshimeve klimatike, por edhe rreziku i pakujdesisë dhe lakmisë njerëzore.

Maqedonia e Veriut është e pasur me trashëgimi kulturore, por, për fat të keq, numri i aseteve kulturore të rrezikuara po rritet. Në rrethana të tilla është e vështirë të përballemi me mirëmbajtjen e parregullt afatgjatë, braktisjen, shfrytëzimin e pahijshëm, ndarjen e pamjaftueshme të mjeteve, mungesën e kuadrit profesional, moszbatimin e sanksioneve ligjore dhe ndërgjegjësimin e pamjaftueshëm për vlerat e trashëgimisë kulturore. Nëse kësaj bisede të hapur për dobësitë tona i shtojmë vrullin shkatërrues të ndryshimeve klimatike, si dhe “lajmet e këqija” për pasojat për vendet e Evropës Juglindore, është i nevojshëm një mobilizim i përbashkët për bashkëpunim me UNESCO-n dhe komunitetin ndërkombëtar.

Mekanizmat fleksibël dhe harta e cenueshmërisë janë mjete të mira parandaluese përmes shkëmbimit të informacionit, përvojave, njohurive, vlerësimit të cenueshmërisë, projekteve dhe programeve për të marrë masa përshtatëse në kohë.

Sepse ndryshimet klimatike në thelb po “sulmojnë” vlerën universale të trashëgimisë kulturore.

Ajo që ndodh në Arktik nuk qëndron në Arktik.

Faleminderit!